

SI FILLOHET NJË KALENDAR:

Biseda mbi shoqatat e para të grave në Shqipëri
pas vitit 1991

VALENTINA BONIZZI

Hyrje¹

Kalendarët ishin një ndër elementet e përfshira në ekspozitën e parë të *Ditarëve: LindArt & Shoqata e Grave Artiste Shqiptare*. Ekspozita u hap më 2022, në vijim të përpjekjeve disavjeçare nga ana ime, për të zhbiruar punën e shoqatës “Linda”, shoqata e parë dhe e vetme e grave artiste në Shqipëri pas rënies së regjimit komunist më 1991. E konceptuar më 1993 dhe e themeluar më 1994 nga 14 gra artiste që ishin pjesë e skenës artistike në atë periudhë, “Linda” iu përgjigj nevojës për të krijuar mundësi të reja për të mësuar, në një kontekst ku traditat e vjetra patriarkale vazhdonin të formësonin zhvillimin e kulturës dhe të artit pamor. Në vitin 2000, kolektivi hapi Qendrën Kulturore “LindArt”, dhe midis viteve 2001 dhe 2010 kjo qendër ndërtoi një program ku përfshiheshin ekspozita, punëtori dhe të tjera ngjarje.

¹ Përkthyer në shqip nga Jonida Gashi.

Pas një sërë përpjekjesh të dështuara për të gjetur financim dhe një hapësirë për projektin *Ditarët*, vendosa që mundësitë e ofruara nga Bulevard Art & Media Institute,² një hapësirë e sapothemeluar, ishin mënyra e duhur për të filluar ndarjen e këtij kërkimi me publikun. Aktualisht, *Ditarët* janë duke u transformuar në një arkiv të konceptuar si një e mirë publike, një arkiv i cili e hedh vështrimin mbi prodhimin artistik kolektiv të viteve 1990 dhe të dekadës së parë të viteve 2000, nëpërmjet thjerrës së “LindArt” dhe Shoqatës “Linda”. Kur u hap ekspozita e parë e *Ditarëve*, më 23 qershor 2022, në të ishin përfshirë edhe Kalendarët, të cilët ishin shkruar mbi dy tavolina të gjata e të ndriçuara (*lightboxes*), dhe që mbulonin një hark kohor nga viti 1990 e deri në vitin 2010, vit në të cilin Qendra “LindArt” u mbyll. Si aktin e parë të një procesi bashkëndarjeje, rivendikuam punën e Qendrës “LindArt” duke e përfshirë programin e saj në hartën e njohur të ngjarjeve artistike në vend gjatë këtyre viteve. Një stilolaps i vendosur midis dy tavolinave i dha publikut mundësinë për të ndërhyrë, duke e bërë procesin të hapur dhe ndërveprues. Dhe, me të vërtetë, kishte pjesëmarrje aktive – sikurse mendoj që, me gjasa, ekzistonte nevoja, ose një dëshirë, për të rivendikuar përfaqësimin individual brenda një kolektivi, brenda narrativave historike zyrtare të dekadave post-komuniste. Kjo narrativë, e ngritur mbi vlera patriarkale, theksonte rritjen në një ekonomi kapitaliste me ritme të shpejta dhe negociimet gjeopolitike brenda Evropës, por ajo ndërtoi, gjithashtu, një urë midis një regjimi komunist të egër dhe

² Bulevard Art & Media Institute është një hapësirë e themeluar rishtazi në Tiranë nga Valentina Bonizzi dhe Sonila Abdalli, që u hap më 23 shtator 2021. Për më tepër, shikoni faqen e hapësirës në rrjet: www.bulevard.al.

Si fillohet një kalendar...

pluralizmit, dhe shumë prej aktorëve politikë të së kaluarës nuk u larguan përfundimisht nga skena, por, përkundrazi, vazhduan të marrin pjesë në sfidat politike të vendit.

Krahas kësaj narrative zyrtare, Kalendarët ofrojnë një tjetër perspektivë. Përmes dialogut, Kalendarët transformohen në një formë rrëfimi personal që arrin të depërtojë, në mënyrë intime, në brendësi të dinamikave të krijimit të hapësirave. Shpresoj që, nëpërmjet këtij procesi, Kalendarët do të nxjerrin në pah disa elemente që mundësojnë zhvillimin e një këndvështrimi kritik, vetëm pasi të jemi ndjerë disi më afër me këto histori, duke shmangur përjetësimin e izolimit të personazheve brenda këtyre narrativave.

Në këtë moment, *Ditarët* dhe arkivi po “shkruhen”, në mënyrë të tillë që brenda kolektives vendohet personalja: një punë arkivore që po shndërrohet në një metodë për të “ndërtuar një shtëpi”, me të gjitha ndërlikimet dhe politikat që nënkupton ky proces.

Në faqet në vijim paraqes disa nga dialogët që kanë qenë të domosdoshëm për të kuptuar kontekstin në të cilin ka ekzistuar Shoqata e Grave Artiste Shqiptare. Ata synojnë të nxjerrin në plan të parë rolet që kanë luajtur gratë dhe përvojat që kanë patur gratë në dekadat e hetuara nga projekti *Ditarët*. Këta dialogë përfaqësojnë një hap krejt fillestar që synon të ngrejë bazat për zhvillimin e akoma më shumë perspektivave kritike në të ardhmen.

Eleni Laperi është një historiane arti, autore dhe kuratore e lindur në Tiranë më 1949. Ajo ka qenë presidente e Shoqatës së Grave Artiste Shqiptare “Linda” (1993-2010) si dhe drejtore e

Qendrës “LindArt”, e vendosur në veprim nga Shoqata “Linda”, që ishte aktive midis vitve 2000 dhe 2010. Eleni Laperi vazhdon të punojë si autore e pavaruar.

Vjollca Meçaj është një avokate e lindur në Durrës më 1951 dhe e rritur në Tiranë. Ajo është themeluese e Shoqatës së Grave Avokate dhe ka qenë, gjithashtu, anëtare aktive e shoqatës së parë të grave në Shqipëri, “Refleksione”. Vjollca është tashmë pensioniste por vazhdon të jetë aktive në dialogët me shoqërinë civile.

Shoqata e Grave “Refleksione” është një shoqatë joqeveritare, jofitimprurëse e krijuar në Tiranë më 27 shkurt 1992. Refleksione u themelua nga një grupim grash të arsimuara që ishin të shqetësuara rreth të drejtave të grave në Shqipëri në periudhën menjëherë pas kalimit të vendit nga një regjim totalitar në një demokraci. “Refleksione” mbledhi bashkë gra me përvojë të larmishme jetësore, që vinin nga grupime politike dhe fetare të ndryshme, të cilat fillimisht u angazhuan në përpjekjet për të edukuar veten dhe gratë e tjera mbi të drejtat e tyre, si dhe për t’i parë me një sy kritik ndryshimet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore që po përjetonte vendi dhe mënyrën se si ato po preknin vajzat dhe gratë në veçanti. Me kalimin e viteve, “Refleksione” u shndërrua në një organizatë udhëheqëse lobimi që ofron shërbime dhe punon për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri.³

³ Për më tepër mbi shoqatën “Refleksione”, shikoni faqen e saj në rrjet: <http://refleksione.org>.

NGA ARKIVI I LINDART-IT: BISEDË E MËPOSHTME
ËSHTË SHKËPUTUR NGA NJË DOKUMENTAR
I TVSH-SË MBI SHOQATËN “LINDA”.

Dokumentari u xhirua nga Xhemal Reci. Intervistuesja është Mimoza Ahmeti, një shkrimtare, poete, piktoresh dhe këngëtare e njohur e lindur në Krujë më 1963.

Mimoza Ahmeti: Organizimi juaj, si shoqe krijuese, për të bashkërenduar punën, a ju krijon avantazh? Apo është thjesht një veprim etik juaji ndaj artistit?

Eleni Laperi: Ne... ne vendosëm të mblidhemi, të krijojmë një shoqatë të tillë, të grave artiste, jo se ne mendojmë se gratë artiste duhet të punojnë dhe të veprojnë në një shoqatë të veçantë, po sepse është vetë shoqëria që ka krijuar një ndarje në gra artiste dhe në burra artistë. Sepse, për mendimin tim, nuk ndahet, nuk mund të ndahet artisti në artist burrë dhe artist grua. Ka artistë të mirë dhe artistë të këqinj. Ka artistë të njohur dhe artistë të panjohur. Ka artistë që e njohin famën e tyre që në të gjallë dhe ka artistë të famshëm të panjohur. Pra, ky ishte qëllimi jonë, që ne të kemi mundësi që të ndihmojmë njëra-tjetrën. E kemi të nevojshme këtë gjë, sepse... unë nuk e di se pse, po tërë jetën, gratë janë trajtuar si diçka më vete. Një gjë që për mua ishte një zbulim, ishte kur lexova që vetëm në 1500-n, me anë të një libri që shkruajti Baldassare Castiglione, shprehej nevoja për të arsimuar gruan, për t'i mësuar gruas shkrimin dhe këndimin, për t'i mësuar gruas diçka nga artet, për t'i mësuar gruas se si të silltet në shoqëri, dhe kjo jo që të përgatiste gruan për karrierë, por që

të përgatiste gra bashkëshorte – një sfond të bukur për burrat që ato do merrnin. Dhe kjo ishte vetëm për gratë aristokrate, sepse gratë të tjera e kishin të ndaluar të arsimoheshin, vetëm murgeshat mund të mësonin shkrim dhe këndim.

Gjatë gjithë historisë së njerëzimit, ka pasur gra artiste, të mëdha. Plini i Vjetër, që në kohët e lashta, përmend Timarete-n, përmend Eirine-n, përmendet Helena e Egjyptit. Me kalimin e kohës, në Rilindje, pati gra artiste të mëdha, kanë qenë pesë motrat Anguissola në Itali. Duke ardhur, me kalimin e kohës, është shtuar numri i grave artiste, dhe sot gruaja ka arritur të jetë... ka arritur t'i afrohet barazisë me burrin në fushën e artit. Sepse në Rilindjen italiane ndonëse filloi t'i lejohej gruas të punonte, të trajtonte... megjithatë i lejohej vetëm të trajtonte natyrën e qetë, portretet, nuk i lejohej të trajtonte nudon, nuk i lejohej të trajtonte temat historike, tablo të mëdha, të rëndësishme. Me një luftë shumë të madhe, me një personalitet shumë të madh kanë arritur vetë gratë t'i detyrojnë njerëzit të pranojnë punën e tyre. Kjo ishte një arsye që na shtyu ne që të krijojmë një shoqatë të grave artiste.

ELENI LAPERI

Tiranë, 13 janar 2020

Biseda u zhvillua në ambientet e “Kino” Bar, Tiranë

Eleni Laperi: Kam lindur në Tiranë. Shtëpia jonë ndodhej jashtë qytetit, në mes të një fushe të madhe. U rrita në kontakt me natyrën, me barin; kisha shumë qejf të ecja zbathur mbi bar. Kishim edhe bagëti, shpendë, një kopësht ku punonim në kohën e lirë. Pra, linda e u rrita në Tiranë, shkollën e kisha në qytet, por jetoja si në fshat. Vëllai im i madh ishte oficer në ushtri dhe i pëlqente shumë të vizatonte. E shihja kur zmadhonte fotografi të artistëve të kinemasë, duke i ndarë me katrorë sipërfaqen e letrës dhe të fotografive. Kështu, fillova edhe unë të zmadhoja foto, kur isha në shkollën e mesme. Më pas aplikova për të hyrë në Universitetin e Arteve, që asokohe quhej Instituti i Lartë i Arteve. Nga piktori Zef Shoshi mora disa këshilla se si të punoja në konkursin e pranimit. Ishte viti 1967. Mora pjesë në konkurs dhe fitova të drejtën të studioja në Atelienë e Pikturës. U diplomova në vitin 1972 dhe nisa të punoja si grafiste në revistën *Shqiptarja e re*, e cila botohej nga Bashkimi i Grave të Shqipërisë, një organizatë që, si gjithë të tjerat e kohës, ishte pjesë e zinxhirit të propagandës së Partisë së Punës, partia në pushtet.

Valentina Bonizzi: Mund të kthemi tek Instituti i Lartë i Arteve? Si ishte struktura e tij, çfarë mësove?

E.L.: Në ato vite dega e Arteve Pamore kishte vetëm

ateliënë e pikturës dhe ateliënë e skulpturës, dhe studimi vijonte pesë vite. Më pas u shtuan edhe degët e tjera, si grafika, skulptura e aplikuar, tekstili, etj. Përveç pikturës dhe vizatimit, kishim edhe lëndë teorike, si historia e artit, marksizmi, gjuha ruse. Çfarë mësova? Jo shumë, pasi vetëm kur i mbarova studimet kuptova se atëherë isha në gjendje t'i rinisja ato, pasi tanimë e dija se çfarë duhet të bëja në shkollë. Fatmirësisht isha e aftë të lexoja në Italisht e në Frëngjisht, kështu që u miqësova me njërën nga bibliotekaret e Institutit. Merrja për të lexuar libra, që në atë kohë studentëve nuk u lejohej t'i merrnin. Sepse jo të gjithë librat e bibliotekës ishin të lejuar për të gjithë. Jo të gjithë studentët e shkollës mund të shihnin çfarë të donin nga librat e bibliotekës. Kishte periudha kur lejoheshin të shkonin në bibliotekë e t'i shihnin të gjithë librat që dëshironin. Kishte periudha kur lejoheshin vetëm një listë e kufizuar titujsh. (Ishte shumë e egër kjo varësi e edukimit nga politikat e Enver Hoxhës dhe e partisë së tij.) Megjithatë, unë kisha mundësi të lexoja të gjithë librat që doja, sepse kisha besimin e bibliotekares. Dhe mbaj mend që kam përkthyer në shqip *Manifeste du Surréalisme* të André Breton-it. E mbaj mend që atë punim ua dhashë shokëve, studentëve të kursit tim. Ishte një libër i hollë, i vogël.

V.B.: Të kujtohet emri i bibliotekares?

E.L.: Ishte italiane, Erika Strazimiri. Një grua e bukur e fjalëpakë, që më ka ndihmuar shumë. Po një herë e frikësova shumë, sepse i mora një libër për t'ua treguar shokëve e shoqeve të klasës e ajo më tha: “Jo Eleni, nuk lejohet, të lutem!”

V.B.: Ishte italiane dhe ishte këtu gjatë komunizmit?

E.L.: Po, sepse ishte martuar me Gani Strazimirin (themeluesin e Institutit të Monumenteve të Kulturës në Shqipëri). Ai ishte arkitekt dhe kishte studiuar në Itali në vitet '30. Ata qenë takuar atje, qenë martuar e patën shkuar në Moskë, më duket gjatë viteve të para të pasluftës. Pastaj ajo jetoi me të në Tiranë. Nuk jeton më, por ka dy vajza në Itali. Kështu, pata mundësinë të shihja e të lexoja libra që nuk gjendeshin tjetërkund. Pastaj, pas shkollës, kisha një tjetër shoqe te biblioteka e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, që ishte në qendër të Tiranës: Flutura Greva. Edhe ajo më jepte libra, nga ata që vinin në bibliotekën e Lidhjes. Mbaj mend që edhe atje kam lexuar shumë libra, edhe letërsi: Umberto Eco-n, Kafkën, Faulkner-in...

V.B.: Dhe, a të kujtohet, gjatë kësaj kohe, Lidhja kishte më shumë anëtarë burra se anëtare gra?

E.L.: Shumica ishin burra, sigurisht. Po kishte edhe gra anëtare të Lidhjes.

V.B.: Por...

E.L.: Kishte një farë rregulli për pranimin si anëtar i Lidhjes: ata që diplomoheshin nga Instituti i Lartë i Arteve (më pas Akademia e Arteve), bëheshin automatikisht kandidatë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Por problem për artistët ishte se nuk kishte materiale në treg, për piktorët për shembull. Dhe për të pasur materiale, për të pasur kanavacë apo ngjyra, të

duhej një shkresë, një leje nga Lidhja e Artistëve... sepse sasia e tyre ishte shumë e kufizuar. Lidhja kishte edhe një formë tjetër ndihme për artistët, një mënyrë tjetër organizimi: duke u bazuar në prodhimtarinë apo në rëndësinë e krijimtarisë së tyre, artistëve u jepeshin leje krijuese, njësoj si veprojnë edhe në Suedi. Artistëve që përfitonin leje krijuese u sigurohej një atelie, një pagesë mujore dhe mundësia të mos shkonin në vendin ku ishin të punësuar, për disa muaj e deri në dy vjet. Këtu shiheshin më qartë diferencimet midis artistëve burra dhe artisteve gra. Ishin më të shumtë piktorët e skulptorët burra ata që përfitonin nga lejet krijuese.

V.B.: Po gratë pse nuk kishin mundësi?

E.L.: Sepse thoshin... Po jap një shembull, kur punoja në Galerinë e Arteve nisa të bëj kërkime për artistët që, para Luftës së Dytë Botërore, kishin studiuar në Itali, apo në vende të tjera evropiane. Ndër ta ishin edhe motrat Sofia dhe Androniqi Zengo. Ato të dyja kishin studiuar në Athinë, ishin diplomuar atje. Kur do të përkujtohej 500-vjetori i vdekjes së Skëndebeut, Lidhja e [Shkrimtarëve dhe] Artistëve vendosi të organizonte një ekspozitë të madhe kushtuar Heroit Kombëtar. Gjatë kërkimeve në arkivën e Galerisë Kombëtare, gjeta një letër të Sofia Zengos drejtuar kryetarit të Lidhjes së [Shkrimtarëve dhe] Artistëve, me anë të së cilës ajo dhe Androniqi kërkonin leje për të marrë pjesë në konkurs. Në përgjigjen e Foto Stamos, sekretari për Artet Pamore në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, shkruhej se ato nuk ishin të afta të realizonin kompozime të mëdha, ndaj duhej të vazhdonin të punonin portrete, peizazhe, natyra të qeta... Pra,

Si fillohet një kalendar...

ata kishin bindjen se gratë piktores e skulptores nuk ishin të afta të realizonin kompozime të mëdha, mbi tema të rëndësishme, tema historike. Dhe në qoftë se i hedh një sy krijimeve të asaj periudhe në galeritë e artit, apo në monumentet e realizuara në ato vite (ndoshta edhe tani) mund të dallosh këtë mungesë në krijimtarinë e tyre.

V.B.: Po gjatë kohës së Akademisë, besoj të gjithë mësuesit e tu ishin burra?

E.L.: Po, përveç njëres, studiuseses Dhorka Dhamo, e cila na jepte Histori Arti. Ajo na ka dhënë disa leksione të Historisë së Artit, por gjithë pedagogët e tjerë ishin burra, po.

V.B.: Dhe kur nise si grafiste, the që po punoje për një revistë të Lidhjes së Grave... *Shqiptarja e re*, si ishte ajo në kontekstin e grave?

E.L.: Revista *Shqiptarja e re* ishte e vetmja revistë e ilustruar kushtuar problemeve të gruas shqiptare. Ishte botim i Bashkimit të Grave të Shqipërisë, një organizatë politike, si gjithë organizatat e asaj kohe. Zyrat e revistës ishin në ndërtesën e Komitetit Qendror të Partisë, (ndërtesa ku tani janë zyrat e Parlamentit dhe të Avokatit të Popullit), në katin e tretë. Edhe organizata Bashkimi i Grave të Shqipërisë ishte në të njëjtën ndërtesë. Kryetarja e organizatës, Vito Kapo, ishte anëtare e Komitetit Qendror të Partisë. Ajo ishte gruaja e një prej përfaqësuesëve kryesorë të Byrosë Politike ([ku bënin pjesë] anëtarët më të rëndësishëm të Partisë, që jetonin në “Bllok” pranë

Enver Hoxhës). Ndërsa punonjëset, instruktoret e organizatës, nuk shquheshin për nivelin intelektual, por ishin pothuaj të gjitha bashkëshorte të dikujt që kishte pozitë.

Fillova të punoj në revistën e tyre në vitin 1972, kur kishte njëfarë lirie rreth e rrotull, kur unë i qepja vetë pantallonat e mia... Sepse te zyrat e BGS-h-së vinte edhe revista *Burda*, një revistë mode, e cila shoqërohej me fletë që të ndihmonin t'i qepje vetë modelet e veshjeve. Kështu unë vishesha si “grua evropiane” e kjo më krijoi probleme. Sepse instruktoret shkuan te Vito Kapo dhe i thanë: Eleni është ekstravagante, ka probleme ideologjike. Unë i bija edhe kitarës, ndiqja stilin e jetës së viteve '70... Ato më kontrollonin edhe ilustrimet që bëja për revistën. Mundohesha të bëja diçka ndryshe. Sapo kisha mbaruar studimet dhe kur je e re mendon se fare lehtë mund të ndryshosh botën. Pra, doja të bëja diçka me të vërtetë ndryshe. Kështu që hulumtoja revistat që vinin në BGS-h, si *Heures Claires*, një revistë franceze për gra. I kopjoja stilet e shkronjave dhe mënyrën e faqosjes, e kështu dizajni i revistës ndryshoi kryekëput, deri sa një ditë një nga shefet e revistës *Shqiptarja e re* më tha, “Nuk mund të vazhdosh me këto lloj grafikash e shkronjash. Duhet të përdorësh stilet shqiptare të shkronjave”. Unë iu përgjigja, “Mirë, atëherë më jepni stilet shqiptare të shkronjave dhe unë do të përdor ato”. Të tilla probleme pata derisa, në fund të viteve '70 dhe në fillimin e viteve '80, nisi të kishte ndryshime gjithkund. U organizuan “kontrolle të punëtorëve” në institucionet shtetërore, të drejtuara nga Partia, nga Enveri. Kështu ata erdhën edhe në revistën ku punoja dhe vendosën që unë e dy kolege, Natasha Lako dhe Zhuliana Jorganxhi, të dyja poete dhe gazetare, të dyja gra mendjehapura, duhej të largoheshim nga

revista, pasi kishim ardhur në një institucion qendror drejt e nga bankat e shkollës. Kështu, mua më dërguan në një ndërmarrje që prodhonte etiketa dhe ambalazhe për produkte të ndryshme, pra jo në institucion kulturor, por në mjedis prodhimi, sepse duhet të “edukohesha” me frymën e klasës puntore... Nisa të punoja në Ndërmarrjen Kartografike.

Por më 1989, pra në fundin e viteve '80, prodhimi shqiptar ishte në krizë të thellë e shteti i varfëruar në kulm, pasi prodhimet tona nuk shiteshin dot jashtë shtetit. Dhe një nga arsyet ishte edhe cilësia estetike e ambalazheve. Atëherë, Ministria e Industrisë së Lehtë mendoi të ndryshonte modelet e prodhimit, kutitë e verës, etiketat e produkteve, etj. Na erdhën në zyrën e modeleve, ku punoja bashkë me katër piktorë të tjerë. Konkuruam për dizajnin më të mirë të ambalazhit të një produkti, dhe unë fitova. Në muajin prill të vitit 1989 mua dhe shefin e zyrës na dërguan në Itali. Donin që ne të shikonim se si punonin grafistët e industrisë jashtë Shqipërisë, të sillnim prej andej njohuri të reja e t'i bënim pjesë të punës sonë. Në '89-n kam qenë në Bari, në Romë dhe në Trieste. Ishte tronditje e madhe për mua. Kur avioni fluturoi mbi Romë mendova, “Oh, Zot! na kanë gënjyer gjithë jetën...” Sepse që të vegjël ishim mësuar të dëgjonim se Tirana ishte qyteti më i bukur e më i gjelbër i Evropës. Po kur pashë Romën... U trondita shumë. Ishte diçka që më ndryshoi tërësisht. Ishte kontakti im i parë i drejtpërdrejtë me kulturën evropiane. Pashë Mikelanxhelon, *Pietà*-në... Në Bari më thanë të qëndroja atje e të punoja me ta... Por unë isha e martuar e kisha tre djem... mendoja pasojat që ata do vuanin. Ishte e pamundur.

Kur u ktheva, iu thashë zyrtarëve të ministrisë, që më

dërguan në Itali, se nëse donin që ne të realizonim punë më të mira, duhej të na siguronin edhe materiale, makineri... gjithçka ndryshe. Nuk punova atje shumë gjatë pas kësaj, sepse Ministria e Kulturës më kërkoi të punoja në një galeri në Tiranë, e quajtur “Salloni i Artit”, një galeri e Ministrisë së Kulturës. Atje shiteshin vepra arti të artistëve tanë, vetëm për të huajt, ngaqë leku shqiptar kishte vlerë të ulët e shtetit i duhej valutë e huaj. Punova në galerinë, që ishte pranë Muzeut Historik, në qendër të Tiranës, ku tani ndodhet një bankë. Ishte një hapësirë prej 250 metrash katrorë.

V.B.: Të kujtohet emri i Ministrit të Kulturës?

E.L.: Ishte Prof. Alfred Uçi. Ishte edhe shkrimtar/filozof. Mua më ka ndihmuar, më ka mbrojtur nga shpifjet. Më donin atje, sepse mund të komunikojë në italisht, në frëngjisht e pak anglisht... Kështu, atje i kam ndihmuar për të bërë goxha të ardhura në valutë të huaj. Më kujtohet erdhi atje njëherë një zotni hebre nga Vjena, një bankier. Erdhi e bleu mbi 20 piktura dhe kërkoi artistë shqiptarë për të pikturuar historitë e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Pra i kam sjellë mjaft të ardhura Ministrisë. Pati nga ata që vajtën në Ministri, si për shembull drejtori i ndërmarrjes që quhej Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, një shkritore ku derdheshin skulpturat në bronz, nga e cila varej galeria, pra edhe unë. Pra, ky drejtor shkoi në Ministri dhe tha: “Eleni mban kontakte me të huajt dhe merr libra prej tyre.” Sepse blerësit kryesorë të “Sallonit të Artit” ishin ambasadorë dhe punonjësit e ambasadave të huaja. Dhe vërtet më jepnin libra, libra arti. Kështu Ministri më thirri në zyrën e tij

bashkë me drejtorin. Unë atë kohë shënoja në një bllok gjithçka që bëja çdo ditë në galeri, ndaj e mora bllokun me vete. Drejtori foli për librat e unë iu përgjigja që po, sigurisht, flisja me ta e kisha marrë libra prej tyre, por unë këtë punë kam, të flas me ta, prandaj më keni marrë në punë. Atëherë ai më akuzoi se u merrja para të huajve. Ndërkohë, arkëtarja e galerisë ishte mbesa e tij, e drejtorit. Kështu, i thashë se nuk ka mundësi të kem marrë para, sepse unë nuk i prek paratë, me paratë merret ajo. Atëherë Ministri i tha Drejtorit, “T’i puthësh duart Elenit, sepse ajo i ka sjellë shtetit shumë të ardhura... prandaj lëre të qetë...”.

Pastaj, erdhën vitet ’90, kur të gjithë mendonin si të përfitonin e të rrëmbenin diçka. Këtë galeri donte ta merrte për vete një nga punonjësit e Ministrisë së Kulturës. Ishte një prej drejtorëve të Ministrisë, që në bashkëpunim me disa italianë, donte ta privatizonte galerinë e ta kthente në një supermarket. Më thanë se duhej të largohesha nga ajo punë, sepse hapësira do përdorej për një tjetër aktivitet. Dërguan edhe një arkitekt italian që të studionte hapësirën. Unë bisedova me arkitektin, i cili pohoi se donin ta shndërronin për aktivitet tregtar, madje më tha edhe emrat e personave të përfshirë në atë plan. Dhe unë botova një artikull për këtë aferë. Drejtori i Ministrisë u betua se do më hidhte në gjyq për shpifje, por unë kisha dëshminë e arkitektit Italian. Kur Ministri e mori vesh këtë gjë, u tërbua. “Salloni i Artit” shpëtoi dhe iu bashkëngjit Galerisë së Arteve, ku nisa të punoj edhe unë.

V.B.: Për cilin vit bëhet fjalë?

E.L.: Më 1991 ose 1992, pak pas rënies së regjimit.

V.B.: Ishte e vështirë kjo kohë?

E.L.: Shumë e vështirë. Ishte si të të goditnin me grusht në fytyrë e të ta kthenin çdo gjë 180 gradë. Nisa punë si studiuese në Sektorin e Studimeve të Galerisë Kombëtare të Arteve. Më duhej të kryeja studime mbi piktorët shqiptarë dhe të huaj në arkivën e Galerisë. Ky sektor, që më parë herë funksiononte e herë mbyllej, tani kishte një staf të plotë. Fillimisht, ishte një punë ku do haseshe me shumë vështirësi, pasi na u desh të ndryshonim mënyrën sesi mendonim për artin, na u desh të ndryshonim mënyrën e të parit të punimeve të artistëve tanë. M'u desh të lexoja shumë, edhe libra mbi filozofinë e artit. Sepse kishim mungesa njohurish për teorinë dhe historinë e artit, për filozofinë, etj. Për shembull, e vetmja gjë që kishim mësuar në lidhje me filozofinë ishin disa njohuri mbi materializmin dialektik. Ishte diçka shumë e çuditshme, sepse ne kishim studiuar Marksën dhe Engelsin, na kishin mësuar, për shembull, çfarë ata kishin thënë për Dyringun, po nuk dinim asgjë se çfarë Dyringu vetë kishte thënë... Pra kishim njohuri gjysmake mbi çështjet teorike, çdo gjë që kishim mësuar deri atëherë ishte gjysmake, edukimi ynë ishte i paplotë... për më tepër, na kishin munguar kontaktet e drejtpërdrejta me krijimtarinë artistike botërore. Na u desh të ndryshonim mënyrën e të menduarit për edukimin. Dhe vijova të kërkoj mundësi për të plotësuar mangësitë që kisha në fushën e dijeve, sidomos pasi na u dha mundësia të kishim internet në Galeri.

Mësova shpejt të përdor teknologjinë, kompjuterin, dhe të përfitoj prej saj. Ajo më dha mundësinë të vendosnim lidhje me galeri e muze të botës, dhe sigurova ftesa prej tyre, si me

Muzeun “Hyacinthe Rigaud” në Francë, me Muzeun Kombëtar të Artit në Bukuresht të Rumanisë, me Muzeun e Artit Modern në Nju Jork... Pata edhe mundësinë të shkoja e ftuar në këto institucione. Në Galerinë Kombëtare janë tre ose katër punime nga artistët rumunë Nicolae Grigorescu, Magdalena Rădulescu dhe disa të tjerë. Është edhe një punim nga piktori francez Rigaud. Kështu shkova në Francë dhe në Rumani dhe nga kontakti me studiuesit atje, kuptova sa të shumta ishin mangësitë në njohuritë tona... Arrita të vihesha në kontakt me MoMA-n në Nju Jork, sepse donim të nisnim një program edukimi përmes artit. Dhe ata na ftuan. Shkuam në Nju Jork për dy javë për të parë se si i organizonin dhe si i përdornin veprat që kishte muzeu për të punuar me fëmijët, për të punuar edhe me familjet, edhe me të rritur. Na treguan edhe se si i nxirrnin të ardhurat për muzeun. Morëm pjesë në një mbledhje të bordit të muzeut, antarë të të cilit ishin pjestarë nga familja Lauder, nga familja Ford e nga disa familje të mëdha, që mbështetnin muzeun. Isha atje me drejtorin e galerisë, Gëzim Qëndron, dhe me studiuesen Suzana Varvarica. Kështu, u kthyem në Galeri, nisëm programin e edukimit dhe... ishte i mrekullueshëm! Ishte prilli i vitit 2000. Kurse vizitat në Rumani, në Paris të Francës dhe në muzeun Rigaud në Perpignan (falë programit Courrant, të organizuar nga Ambasada Franceze), ishin në vitet '90.

Fillova të mësoj se si funksiononte një muze dhe si përdorehin veprat e artit në procesin e edukimit dhe në marrëdhënien me publikun. Pamë si mund të ekspozoheshin veprat e artit në një muze, jo vetëm duke organizuar ekspozita. Gjithashtu, mësuam se si të ekspozonim vepra të medieeve të ndryshme, për shembull fotografinë dhe pikturën, nën një temë

të përbashkët. Nga kjo eksperiencë mundëm të realizonim në Galeri një program edukimi, i cili shkoi shumë mirë. Pjesëmarrës ishin fëmijë të shkollave fillore, deri edhe nxënës të gjimnazeve. Në vitin 2000 pata mundësinë të bëja një projekt për një Qendër Kulturore të Grave Artiste. Po më parë, duhet të them se në vitin 1994 themelua një Shoqatë të Grave Artiste, në Tiranë. Isha unë dhe disa gra të tjera artiste, si Lumturi Blloshmi, Suzana Varvarica, etj.⁴ Ishte shoqata e parë e grave artiste në Shqipëri, pas viteve '90. Dhe filluam të bënim shumë aktivitete. Mund të të dërgoj CV-në time, ku janë shënuar të gjitha aktivitetet tona. Ndërsa në vitin 2000, fondacioni Pro Helvetia në Tiranë kërkonte të financonte një projekt për një qendër kulturore. Falë interesimit të juristes Vjollca Meçaj, unë e mësova këtë gjë dhe hartova projektin për Qendrën Kulturore të Grave Artiste, që e quajtëm “LindArt”, me kuptimin e lindjes së artit; pak romantike, por... gjithsesi, ishte mendësia e kohës...

Falë edhe mbështetjes që na dha Vjollca Meçaj, drejtori i fondacionit, Christian Zindel, e aprovoi projektin. Fituam

⁴ Lista e anëtareve themeluese të Shoqatës “Linda” më 1993 dhe në kohën e legalizimit të shoqatës më 1994 – në rend alfabetik: Anila Zajmi, lindur në Tiranë më 1958; Djana Miziri, lindur në Durrës më 1951; Drita Saliu, lindur në Burrel më 1952; Eleni Laperi, lindur në Tiranë më 1949; Fabiola Jozja, lindur në Tiranë më 1973; Flutura Preka, lindur në Shkodër më 1970; Ikkal Beli, lindur në Tiranë më 1950; Ikkal Kalaja, lindur në Shkodër më 1959; Keti Jazexhiu, lindur në Tiranë më 1950; Lindita Çapunji, lindur në Tiranë më 1964; Lumturi Blloshmi, lindur në Tiranë më 1944; Marjana Eski, lindur në Tiranë më 1951; Mimoza Arapi (nuk ka të dhëna); Najada Hamza, lindur në Tiranë më 1966; Raimonda Mato, lindur në Librazhd më 1957; Rikarda Nenshati, lindur në Shkodër më 1965; Silvana Nini, lindur në Tiranë më 1969; Suzana Varvarica Kuka, lindur në Tiranë më 1955; Xheneta Kadillari, lindur në Shkodër më 1959; dhe Zanfira Heta, lindur në Tiranë më 1963.

mbështetjen financiare dhe po atë vit gjetëm ndërtesën,⁵ dhe nisa të organizoja hapësirën për atë qendër kulturore, e cila funksionoi deri në vitin 2010, kur e ndjeva veten shumë të lodhur, pasi kisha shpenzuar shumë nga buxheti im personal, sepse po ndeshesha me shumë korrupsion përreth... Kemi bërë mjaft aktivitete, disa ekspozita në galeri e muze, në vendin tonë e jashtë shtetit, por edhe në Qendrën tonë “LindArt”, mund të bënim ekspozita edhe në hapësirën tonë. Megjithatë, ekspozita jonë e parë dhe më e rëndësishme ka qënë ekspozita *Dare to be different*,⁶ e organizuar në vitin 2001 në qytetin e Fierit. Falë ndihmës e kontakteve me filozofen sllovene Marina Gržinić, arritëm të sjellim gra artiste nga më të njohurat nga të gjitha vendet e Ballkanit. Ka qënë edhe ekspozita më e lodhshme, me buxhetin më të vogël. Në vitin 2007, po nga Fondacioni Pro Helvetia, gjeta mbështetje për projektin 5.6, një projekt që mundësonte zhvillimin e programit të një shkolle fotografie. Në kurset e realizuara gjatë atij projekti u ftuan fotografë të njohur ndërkombëtarisht për të bërë trajnime me fotografë të rinj shqiptarë. U organizuan edhe ekspozita

⁵ Godina ndodhej në adresën: Qendra Kulturore “LindArt” / Projekt 5.6, Rruga “Kajo Karafili”, Nr. 54, Tiranë, Shqipëri.

⁶ Artistet që morën pjesë në *Dare to be Different (Guxo të jesh ndryshe)* ishin: Gulsun Karamustafa (Turqi), Sejla Kamerić (Bosnje dhe Hercegovinë), Renata Poljak (Kroaci), Rudina Xhaferri (Kosovë), Zake Prelvukaj (Kosovë), Merita Koci (Kosovë), Zvonka Simčić (Slloveni), Esra Alicavusoglu (Turqi), Esra Ersen (Turqi), Secil Yersel (Turqi), Tanja Ostojić (Serbi), Vesna Duni (Maqedonia e Veriut), Irena Paskali (Maqedonia e Veriut), Aliki Moschis (Greqi), Eleni Theofilaktou (Greqi), Adelina Popnedeleva (Bullgari), Alla Georgieva (Bullgari), Marilena Preda Sanc (Rumani), Tinkuta Pary (Rumani), Diana Miziri (Shqipëri), Lumturi Blloshmi (Shqipëri), Suela Muça (Shqipëri), Doris Sala (Shqipëri), Elsa Martini (Shqipëri), Merita Spahija (Shqipëri), Rudina Memaga (Shqipëri), Mira Brojka (Shqipëri), Flutura Lace (Shqipëri), Suzana Varvarica (Shqipëri) dhe Riketa Mamaj (Shqipëri).

fotografie, si konkursi ndërkombëtar për fotografë të rinj, “Sotiri”, me mbështetjen e Bashkisë së qytetit të Korçës.

V.B.: Si perceptohej Qendra e Grave Artiste?

E.L.: Në fillim, kur kishim edhe mbështetje financiare, organizuam aktivitete nga më të ndryshmet, që nga ekspozitat me artistë profesionistë, deri te *workshop*-et e grave artiste shqiptare me artiste të huaja, bashkëpunime me artistë e grupe artistësh nga e gjithë bota, takime letrare, punë me fëmijët, etj. Kishim mbështetje dhe njerëzit kishin dëshirë të vinin kur organizonim evente. Kishim audiencë të madhe. Por kjo zgjati sa kohë që mundëm të siguronim mbështetje për të paguar qiranë, njerëzit që punonin me ne dhe të ftuarit. Ndërsa shteti nuk na mbështeti asnjëherë.

V.B.: Ç’mendim kishte për feminizmin në atë kohë në Shqipëri?

E.L.: Nuk pranohej mirë, sepse ndeshte kundërshtinë e kolegëve burra. Ata e kthenin idenë e të pasurit një lëvizje feministe në diçka qesharake, kështu që gratë artiste nuk donin të shpreheshin si pjesë e lëvizjeve për të drejtat e grave. Kishin interes të bënin vetëm art, por pa e quajtur veten feministe...

V.B.: Pra nuk kishte asnjë diskutim mbi rolin e gruas, për shembull, në ekspozita dhe në veprat e tyre?

E.L.: Kishte, edhe nëpër trajnime, edhe në takime me gra

Si fillohet një kalendar...

të ndryshme, me artiste nga shtete të tjera si Kanadaja, Ballkani, Zvicra... Ky diskutim bëhej, diskutimi mbi gjendjen e gruas, të gruas artiste, mbi arsyet e kësaj gjendjeje, mbi mënyrat e daljes nga kjo gjendje...

V.B.: Por pastaj nuk çohet përpara prej kontekstit të këtushëm?

E.L.: Ndoshta sepse aktivizmi shihej si diçka që nuk kishte lidhje me artin. Kishte vepra arti, që shprehnin dëshirat e artistes si grua, por nuk kishte dëshirë që këto vepra të prezantoheshin si pjesë të një lëvizjeje feministe.

V.B.: A kishte dijeni për literaturën rreth lëvizjes feministe?

E.L.: Jo [në mënyrë] kaq të drejtpërdrejtë... Pati një *workshop*, për shembull, të ideuar nga artistja Tanja Ostojčić, ku u diskutua situata e grave në art. Po pjesëmarrëset nuk dëshironin të shpreheshin si aktiviste të lëvizjes feministe. Kishte gjithmonë njëfarë...

V.B.: Këto ishin gjithashtu vitet e Bienales së Tiranës... A keni marrë pjesë?

E.L.: Jo drejtpërdrejt. Për të nxitur diskutimet mbi tema të ndryshme, ne patëm organizuar takime, që i quajtëm “Darkat e Platoni”. *Workshop*-i me Tanja Ostojčić-in, ku ishin përfshirë edhe një seri bisedash rreth një tavoline të shtruar, koinçidoi me

hapjen e konkursit “Onufri”. Tanja bisedoi me Edi Mukën dhe një prej këtyre bisedave rreth tryezës u përfshi në programin e “Onufrit”, në hapësirat e Galerisë. Po kjo ishte pjesë e punës së Tanja-s.

V.B.: Por Bialja e Tiranës që organizuar prej Edi Mukës dhe Galerisë Kombëtare. A u ftua Qendra e Grave Artiste, a u njoh fakti që ekzistonte?

E.L.: Jo. Siç ju thashë, ne u gjendëm atje vetëm falë nismës së Tanja-s.

V.B.: Le të themi se Bialja e Tiranës organizohet sot. Me shumë mundësi, ata do ta njihnin [Qendrën e Grave Artiste], për të qenë politikisht korrekt.

E.L.: Mundet. Ndoshta mund të ketë ndryshuar diçka në mendësinë tonë në përgjithësi. Tani ndoshta është ndryshe, edhe pse nuk e njoh mirë skenën e artit bashkëkohor, pasi jam e fokusuar në një tjetër periudhë studimesh. Por, për gratë artiste në Shqipëri ka qenë gjithmonë e vështirë. Para viteve '90 dhe të paktën për nja dy dekada më pas, gratë artiste janë trajtuar si “artistë të dorës së dytë”... E ndieje qartë këtë gjë kur shkoje për të kërkuar mbështetje financiare. Ashtu si para viteve '90, kur shumica e atyre që merrnin leje krijuese, që kishin studio, atelie, ishin artistët burra, ndërkohë që vetëm pak gra kishin atelie për të punuar dhe në përgjithësi punonin dy ose tri vetë në të njëjtën studio... Ajo që unë kam provuar në vetën e parë, ishte pamundësia për të gjetur mbështetje për aktivitetet me gratë

Si fillohet një kalendar...

artiste, kur financimi nga Fondacioni Pro Helvetia përfundoi. Kjo pamundësi solli edhe mbylljen e Qendrës Kulturore të Grave Artiste “Lindart” në vitin 2010.

VJOLLCA MEÇAJ

Tiranë, 6 qershor 2022

*Biseda u zhvillua në ambientet e “Academy of Others”,
mbrapa Liceut Artistik “Jordan Misja”⁷*

Vjollca Meçaj: Nga të fillojmë?

Valentina Bonizzi: Le të fillojmë me ty.

V.M.: Çfarë do të dish rreth meje?

V.B.: Do të doja të dija mbi kujtimet tuaja të para të Tiranës. Nga këtu jeni?

V.M.: Po, nga Tirana jam. Në të vërtetë, kam lindur në Durrës, pasi babai im ishte ushtarak dhe në kohën e lindjes time ai ishte gjithnjë në lëvizje. Kam lindur në Durrës po nuk është se e mbaj mend, sepse isha vetëm disamuajshe kur u zhvendosëm në Shkodër, nga e cila gjithashtu kam fare pak kujtime duke qenë se isha vetëm 4 vjeçe kur prindërit e mi u zhvendosën në Tiranë, dhe kanë lëvizur përsëri që atëherë. Jam arsimuar në Tiranë, që nga shkolla fillore e deri në përfundim të universitetit. Banoja në Rrugën e Durrësit dhe frekuentoja shkollën “Qemal Stafa”, një ndër shkollat më të mira të Tiranës. Pas gjimnazit studiova për drejtësi. Fakulteti im ishte aty ku sot ndodhet Fakulteti i Inxhinierisë. Qe një përvojë e mirë për mua: kisha një biçikletë të kuqe sepse ishte shumë e thjeshtë të lëvizje nëpër Tiranë,

⁷ Përkthyer në shqip nga Jonida Gashi.

kishte shumë pak makina. Tani që e mendoj, kur dilte gjelbërimi në pranverë ishte me të vërtetë bukur, sepse e bëja rrugën deri në Fakultetin Juridik vetëm. Është një kujtim i bukur që më vjen ndërmend në këtë çast. Në kohën që kam bërë studimet, jo të gjithë mund të shkonin në universitet.

V.B.: Kur keni lindur?

V.M.: Më 1951, jam plakë. Por dua ta jetoj jetën derisa të më kenë shteruar të gjitha energjitë! Pra, shkollën e mesme e mbarova në vitin 1968 dhe katër vite paskëtaj u diplomova [nga universiteti]. Siç të thashë, në atë periudhë jo kushdo mund të shkonte në universitet. Kishte dy kriterë. Kriteri i parë ishte statusi politik i familjes: kështu, për shembull, ata që kishin të afërm që ishin dënuar nga regjimi nuk mund të vazhdonin studimet, edhe nëse ishin studentë të shkëlqyer. Kriteri i dytë ishin notat e shkollës së mesme. Ashtu ndodhi që vendosa të ndjek studimet për drejtësi. Për të qenë e sigurtë, nuk është se kisha shumë njohuri mbi këtë fushë, por pasi i fillova studimet e ndjeva që i përshtatej shpirtit tim, sa i përket drejtësisë sociale. Pas studimeve, shteti të ofronte një vend pune – nuk e zgjidhje vetë vendin e punës. Mua më caktuan në një post në Vlorë, në sektorin e prokurimeve. Në atë kohë takova edhe bashkëshortim tim, Edmondin. Pas një viti ai u transferua në Berat.

Kështu, vajtëm në Berat të dy bashkë dhe pas 8 vitesh erdhëm në Tiranë. Bashkëshorti im erdhi i pari dhe, pas lindjes së fëmijës tim të parë, iu bashkova edhe unë. Në Tiranë e lashë pas karrierën në gjykatë dhe u bëra këshilltare juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës, që në atë periudhë ishin të

bashkuara. Asokohe, Ministrja ishte një zonjë, Tefta – Tefta Cami. 3 ose 4 vjet më vonë, qeveria vendosi të ndajë ministrinë, njërin për arsimin dhe tjetrin për kulturën, dhe unë vendosa të punoj në Ministrinë e Kulturës. Ministria e Kulturës dhe e Arteve ishte një etapë të re në jetën time. Punova atje për 7 vjet dhe kur ndërroi regjimi isha akoma në atë post. Kam punuar me dy nga Ministrat e periudhës së kthesës demokratike në Shqipëri; i pari ishte Preç Zogaj – ai ishte një poet dhe njeri shumë i hapur. Në atë Ministri pakkush merrte vesh nga ligjet sepse që të gjithë ishin artistë dhe shumica e atyre që kishin punuar në Ministri para demokracisë i kishin hequr nga puna. Kjo ndodhi më 1991.

V.B.: Pra më 1991 ju qëndruat në Ministrinë e Kulturës?

V.M.: Më herët kisha punuar në Ministri si juriste dhe si sekretare e përgjithshme, dhe pastaj qëndrova atje. Ata kishin nevojë për dikë dhe unë isha e vetmja që e njihite shumë mirë legjislacionin mbi çështjet përkatëse. Nuk ishte e lehtë të gjeje dikë që të mësonte gjithçka nga e para; shumëkush e pati të vështirë të orientohej. Më kujtohet, gjithashtu, që Ministria ndodhej në Rrugën e Durrësit, aty ku sot ndodhet Ministria e Arsimit. Më caktuan që të shkoja e të mësoja se si funksiononte një Ministri në një sistem tjetër; në këtë rast në demokraci. Kishin nevojë për dikë që e kuptonte si anën organizative ashtu edhe atë ligjore. Prandaj, më dërguan në Itali. Vajta në Romë dhe më pritën departamente të ndryshme të Ministrisë italiane të Kulturës, në çdonjërin prej të cilave kalova ca kohë. Për më tepër që dija edhe italisht; e kisha mësuar në mënyrë autodidakte.

V.B.: Ju kujtohet se në cilin muaj vajtët në Romë?

V.M.: Duhet të ketë qenë muaji gusht ose shtator, sepse e mbaj mend që kishim veshur bluza me mëngë të shkurtra. Më kujtohet shumë mirë edhe vendi ku qëndruam, një hotel në Piazza Venezia me emrin “Tre Papi”. Ndodhej në një rrugicë që të çonte në Piazza Venezia. Më dhanë udhëzime të qarta: ti do të flesh këtu; këtu ka edhe një restorant ku mund të hash tri herë në ditë, mjafton të firmosësh; aty përballë është një stacion, duhet të marrësh autobuzin e linjës 64, dhe më dhanë një tufë me bileta.

Ditën e parë më shoqëruan deri te departamenti i Ministrisë. Më kujtohet që atë ditë Ministri apo zëvendës Ministri, në takimet me drejtuesit e departamenteve, tha: Vjollca është nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë, dhe do t’i duhet të mësojë nga të gjitha departamentet, prandaj ajo do të jetë e ftuara juaj. Pra, ditët [e javës] i kaloja duke biseduar me ta dhe duke mbajur shënime, kurse në fundjavë bëja pushim.

V.B.: Ju kujtohet se kush ishte Ministër Kulture në atë periudhë?

V.M.: Jo, ka kaluar shumë kohë.⁸

V.B.: Sa gjatë ndenjët atje?

V.M.: Rreth një muaj e gjysmë.

⁸ Bëhet fjalë për periudhën e qeverisjes së Giulio Andreotti-it, i cili dha dorëheqjen më 1992.

V.B.: Si ndiheshit në lidhje me gjërat që po mësonit?

V.M.: Në rradhë të parë, ndieja një përgjegjësi kaq të madhe saqë më friksonte së tepërmi. Vetëm mendimi që kur të kthehesha në Shqipëri do të mbaja mbi supe përgjegjësinë për reformimin e Ministrisë ishte një sfidë shumë e madhe për mua. Mendoja që nuk ishte diçka e lehtë, sepse mund të vëzhgosh disa gjëra dhe mund të përcjellësh disa gjëra dhe të bësh riorganizime, por ishte e vështirë: nuk mund të arrihej menjëherë sepse duhej ndryshuar pjesa më e madhe e legjislacionit, por më përpara duhej të organizoheshin normat.

Ky ishte hapi i parë, po rezultatet nuk u dukën menjëherë. Problemi kryesor ishte se arti nuk përbënte më një të mirë publike. Ai ishte një pronë private tashmë, çka përbënte dallimin kryesor, dhe unë, si juriste, e kuptova që si fillim duhet të ndryshonim kushtetutën, kodin civil, dhe të organizonim legjislacionin mbi pronën private – si materialen ashtu edhe intelektuale, – legjislacion që mungonte, pasi nën regjimin komunist ky aspekti i së drejtës nuk ishte zhvilluar.

Nën regjimin komunist kishte patur disa forma prone private: disa njerëz kishin shtëpi private, por bëhej fjalë për gjëra të vogla. Tashmë situata ishte shumë e ndryshme. Vajta prapë në Itali, për t’u trajnuar për të hartuar legjislacionin e ri mbi të drejtat intelektuale. Punova mbi ligjin e parë mbi të drejtat intelektuale, që ishte shumë i kufizuar në krahasim me ligjin italian pasi kushtetuta jonë ende nuk ishte ndryshuar; ajo u ndryshua më 1998.

Edhe në rastin e shoqërisë civile, ne punonim me një ligj të regjimit komunist. Ishte një ligj i thjeshtë mbi organizatat

Si fillohet një kalendar...

joqeveritare, që nuk ishte një fushë shumë e zhvilluar, po që ekzistonte si ligj dhe ne vazhduam ta përdorim për gati 4 ose 5 vjet. Unë kam regjistruar Fondacionin Soros, sepse binte nën juridiksionin e Ministrisë së Kulturës. Pasi përgatita dokumentacionin dhe pasi bëra të gjitha kontrollet e nevojshme, ia paraqita Ministrisë së Kulturës, i cili firmoi dekretin. Ishte Ministria e Kulturës ajo që i ofroi Fondacionit Soros një hapësirë të Piramida, aty ku kishte qenë mauzoleu i Enver Hoxhës. Zyra e Fondacionit Soros ndodhej në katin e parë, djathtas. Muzeu i Hoxhës kishte qenë brenda Piramidës, e cila tani po rindërtohet, dhe pas rënies së regjimit ai u zbraz. U zhdukën të gjitha sendet që kishin qenë në muze dhe nuk e di se çfarë u bë me to. Më pas, vendosën që të futnin diçka tjetër në këtë ndërtesë – një si qendër tregtare? Nuk jam e sigurt si ta quaj – dhe përfunduar që vendosëm Sorosin në katin e parë.

V.B.: Pra, Sorosi ishte brenda Piramidës – interesante...

V.M.: Më pas, ata morën një vilë sepse hasën në rezistencë nga menazhuesit politikë të qeverisë, të cilët, sipas mendimit tim, nuk e kuptonin rëndësinë e shoqërisë civile në demokraci.

V.B.: Pra, ju jeni larguar nga Ministria më 1993?

V.M.: Po.

V.B.: Dhe pastaj punuat si avokate?

V.M.: Po, fillova të punoj si avokate. Fillimisht kam punuar me shoqëritë italiane pasi sipërmarrjet italiane ishin të parat që erdhën [në Shqipëri pas rënies së komunizmit]. Fatmirësisht, shoqëritë italiane nuk ishin të interesuara që të endeshin nëpër gjykata, kështu që më pyesnin se si mund t'i zgjidhnin problemet e tyre në rrugë ligjore, duke qenë se proceset gjyqësore kërkojnë shumë kohë dhe para. Gjithçka po shkonte mirë derisa, në vitin 1997, shpërtheu lufta civile: ra qeveria dhe shqiptarët humbën kursimet e tyre. Njerëzit humbën gjithë ç'kishin dhe bizneset u larguan. Në atë periudhë, kam punuar me koleget e mia që ishin anëtare të Shoqatës së Grave Juriste, pasi të gjitha institucionet e drejtësisë kishin nevojë për burime.

V.B.: Në cilin vit e themeluat Shoqatën e Grave Juriste?

V.M.: Në vitin 1994. Por kisha qenë, që më përpara, edhe anëtare e shoqatës së parë për barazinë gjinore: “Refleksione”. Në atë periudhë punoja akoma në Ministrinë e Kulturës, kështu që ndihmova për regjistrimin e “Refleksione” më 1992.

V.B.: Çfarë ishte “Refleksione”?

V.M.: “Refleksione” ishte një nismë e Valdete Salës, asokohe drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare. Ishim rreth 11 gra: Prof. dr. Andromaqi Gjergji, Delina Fico, Filloreta Kodra, etj.

V.B.: Do të doja të lexoja statutin.

V.M.: Bëmë një punë të mirë me statutin, sepse qëllimi

Si fillohet një kalendar...

ynë ishte të konsultonim qeverinë mbi zhvillimin e politikave për gratë dhe sepse që të gjitha ne ishim gra. Jo vetëm gra të shkolluara po gra që, gjithashtu, kishim njohuri të mira mbi shtetin, që kishim kontakte të mira me jashtë, prandaj mund të ofronim disa ide që vinin nga qytetarët jashtë parlamentit.

V.B.: Dua t'ju pyes, në lidhje me shoqatën e Elenit [Shoqata “Linda”], ju kishit njohje paraprake, apo jo?

V.M.: Po, njiheshim nga shkolla e mesme. Nuk kemi qenë në të njëjtën klasë pasi Eleni është një vit më e madhe se unë, por e njihnim njëra-tjetrën sepse në shkollën tonë nuk kishte aq shumë nxënës.

V.B.: Ju kujtohen aktivitetet që organizoi kjo shoqatë?

V.M.: Jo. Lidhja me Elenin erdhi nëpërmjet Shoqatës së Grave Juriste dhe jo nëpërmjet shoqatës “Refleksione”, që merrej kryesisht me politikë. Ne krijuam këtë shoqatë për zhvillimin e grave mbështetur në të drejtat e barabarta, dhe një nga shërbimet që ofronim ishte shërbimi ligjor falas për gratë në nevojë. Pra, ne i ofronim avokatë [pa pagesë] grave që nuk e përballonin dot një të tillë, dhe gjithashtu ofronim të regjistronim shoqata. Pra, Eleni e dinte, nëpërmjet kolegeve të tjera që, nëpërmjet meje, ajo mund të regjistronte zyrtarisht shoqatën e saj pa kosto.

V.B.: E kuptoj.

V.M.: Bashkë me të tjerë, si pjesë e një grupi më të madh,

kam punuar për krijimin e legjislacionit të ri për organizatat jofitimprurëse. Erdhën edhe specialistë amerikanë për të na ndihmuar, çka përbënte një problem të madh sepse, po ta shikosh me syrin e sotëm, në atë periudhë ne po përqaфонim çdo ndihmë që na vinte nga jashtë, nga çdokush. Por ka ndryshime të mëdha në konceptet juridike midis të drejtës anglo-amerikane (*common law*) dhe legjislacionit evropian. Ne kemi ndjekur dhe vazhdojmë të ndjekim parimet e legjislacionit evropian. Ndërkaq, kur ndihma vinte nga Shtetet e Bashkuara, kjo krijonte një kontradiktë në konceptet ligjore. Kështu, ne e përgatitëm ligjin duke marrë parasysh edhe kuadrin ligjor amerikan, edhe atë evropian.

V.B.: Pra ju e takuat Elenin më vonë?

V.M.: Po, ajo më tha që po bëhej gati të krijonte shoqatën [e grave artiste] dhe më tregoi parimet kryesore të kësaj organizate: çfarë do të bënin, si do të organizohej. Funkcionet kryesore të bordit ishin përcaktuar me ligj tashmë. Pra, e gjithë kjo duhej përkthyer në dokumentacionin përkatës: statuti, akti i themelimit, lista e themeluesve. Këto dokumente duhej t'i paraqiteshin gjykatës për miratim, mbështetur në ligjin e ri. Paskëtaj, organizata duhej regjistruar. Ne përgatitëm gjithë dokumentacionin dhe vajtëm para gjyqtarit, me emrat e themeluesve, dhe i paraqitëm gjykatës të gjitha objektivat dhe aktivitetet e ardhshme të organizatës. Pas miratimit, u kthyem me vendimin e gjykatës për organizatën.

REFLEKSIONE

Tiranë, 16 shkurt 2023

Intervista u zhvillua në ambientet e Bulevard Art & Media Institute⁹

Bashkëbiseduese: Valdet Sala, Vjollca Meçaj, Delina Fico – themeluese të “Refleksione”

Delina Fico: Po të përgjigjem unë meqenëse kam qenë koordinatorja e rrjetit të shoqatave të para të grave në Shqipëri. Kam qenë e para që ka koordinuar Qendrën e Gruas, dhe Qendra e Gruas ka koordinuar rrjetin e parë joformal të shoqatave të grave në Shqipëri. Ishin 12 grupe të tilla [në rrjet]. Grupi i Elenit ishte njëri prej tyre, por nuk kemi pasur të bëjmë shumë me të, përtej faktit që ajo merrte pjesë në takime[t e përbashkëta] dhe ndonjëherë – ndonëse jo gjithmonë – merrte pjesë edhe në aktivitetet e përbashkëta. Nuk jam e sigurt nëse Eleni ishte pjesë e përpjekjeve të përbashkëta që ndërmorëm në lidhje me ligjin e parë për të drejtat riprodhuese. Pra, nuk është se kishim të bënim shumë me njëra-tjetrën. Nuk e mbaj mend – të kujtohet ndonjë aktivitet i përbashkët me organizatën e Elenit?

Valdet Sala: Mbjaj mend që i kam ndjekur aktivitetet e tyre.

D.F.: Ajo që po them është se mënyra se si funksiononte “Refleksione” nuk do të ndihmojë të kuptosh mënyrën se si funksiononte organizata e Elenit.

⁹ Përkthyer në shqip nga Jonida Gashi.

V.B.: Nuk bëhet fjalë për të kuptuar mënyrën se si ka funksionuar Shoqata e Grave Artiste, po për të kuptuar kontekstin në të cilin u zhvillua një shoqatë e gruas në atë periudhë. Pra, ato u zhvilluan për arsyet e tyre...

V.S.: Kur them që herën e parë ne [Refleksione] u takuam te Biblioteka Kombëtare – Vjollca, për shembull, nuk ka qenë e pranishme në këtë takim më të hershëm, por ajo nuk qe e pranishme sepse takimi në bibliotekë nuk ishte një takim zyrtar. Biblioteka ishte vendi i logjikshëm për t’u takuar me Delinën [Fico] dhe Mirelën [Kumbaro] duke qenë se ato kalonin shumë kohë atje, por vendi ku u takuam zyrtarisht për të krijuar organizatën ishte në shtëpinë time. Në katin poshtë, apo jo? Nuk kishim shumë hapësirë [në shtëpi], poshtë ishte kuzhina dhe ne përdorëm bodrumin dhe ai ishte takimi i parë me të gjitha anëtarët. Domethënë, me të gjitha gratë së bashku. Po biblioteka ishte, e ke parasysh – unë takohesha me Delinën dhe të dyja bashkë eksploronim atë se çka ajo ishte, atë se çka ajo përfaqësonte, vizionin e saj për të ardhmen – pra ato ishin takime individuale, le të themi, meqenëse nuk ishim të sigurt se si do të ecnin gjërat. Nuk mund të themelosh diçka nëse nuk ke njerëz që ndajnë të njëjtën filozofi, të njëjtat dëshira, të njëjtin vizion për të ardhmen.

Vjollca Meçaj: Ndoshta gjatë muajit të parë e të dytë, por pastaj ishim të detyruara të regjistronim organizatën dhe aty filloi historia ligjore.

V.B.: Desha të kuptoj se çfarë ndodhi më herët, sepse në

rastin e kësaj historie [ligjore] e kuptoj domosdoshmërinë. Jam kureshtarë të di se çfarë nënkuptoni me të njëjtën filozofi dhe të njëjtin vizion?

V.S.: Ajo që desha të them është se po kalonim një periudhë ndryshimesh të thella. Unë kam qenë idealiste: Kisha besim në idealet e socializmit dhe pastaj kuptova që ai nuk funksiononte në praktikë. Pra, ishte një periudhë e vështirë që kërkonte vetëreflektim – çfarë kishe bërë mirë dhe çfarë kishe bërë keq në jetë, dhe cilat ishin përgjegjësitë e tua individuale për këtë? Si dëshiron të jesh në të ardhmen? Pra, ti e kupton që e ardhmja ndërtohet por se ti nuk e ndërton atë i vetëm apo e vetme – qëndrimi i komunitetit është diçka që mund të ndryshojë për mirë apo për keq, dhe ti nuk je i veçuar apo e veçuar nga e gjithë kjo. Nevojitet realizëm, pasi gjërat mund të mos shkojnë ashtu siç do ti, meqenëse unë doja që socializmi të bëhej realitet. Prandaj, ndonëse edhe sot ka nga ata që e ëndërrojnë [socializmin], unë nuk e ëndërroj pasi e kam jetuar.

Por, e ke parasysh, ishte një qasje që e vendosëm bashkërisht. Ne i përkisnim brezave të ndryshëm, ndaj mendoja se që të gjitha ne po reflektonim mbi përvojat tona, mbi atë se çfarë ishte secila prej nesh dhe mbi atë se çfarë ishin të tjerat. Unë isha kaq – jo kureshtarë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, sepse adoleshencën e kam kaluar në gjirin e familjes – por doja të eksploroja atë se çfarë dëshironin të tjerat. Mendoj se për të qenë vetvetja duhet të dish se kush je, sikurse edhe të tjerët duhet të dinë se kush je ti. Gjë që, praktikisht, nuk ka për të ndodhur para moshës 30-vjeçare duke qenë se ti nuk e di se kush je dhe as të tjerët nuk e dinë se kush je ti [më përpara]. Pra, doja që ky brez i

ri [vajzash dhe grash] që ishin që të gjitha nën moshën 30-vjeçare, të ribënte kërkimin tim personal sipas vullnetit të tyre, ëndërrave të tyre për të ardhmen. Zbulova që ato ishin më të zonjat se unë. Pra, në grupin që u krijua unë isha ndoshta më e madhja në moshë.

D.F.: Gjëja tjetër interesante ishte se, në fillimet tona, ne merreshim më tepër me gjërat që vetë ne i gjykonim si të rëndësishme. Pra, nuk ndikoheshim dhe aq nga ajo se çfarë po ndodhte në atë periudhë me lëvizjen e grave në botën reale. Kjo në vitin 1991, '92 dhe '93 do të thoja. Paskëtaj, po. Në një prej aktiviteteve tona të para, përkthyem Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave, pasi menduam që ishte e rëndësishme: ishte një dokument ligjor vendimtar. Pra, në atë periudhë u përqendruam te të drejtat pasi na u dukën [më] të rëndësishme. Me lëvizjet e grave filluam të lidheshim më shumë më '93 dhe '94.

V.S.: Ne nuk ishim nga ata tipa që mendonin globalisht dhe vepronin lokalisht.

D.F.: Megjithëse më kujtohet se, që në fillim, kishim lidhje me një organizatë gjermane, që e ndihmoi “Refleksione” – po edhe ky ishte një grupim i thjeshtë, një grupim mbështetësesh. Në fakt, dua të them diçka pozitive mbi lëvizjen e grave: ne nuk u themeluam me kërkesë të donatorëve, apo sepse dikush na tha që kjo ishte ajo çka duhej bërë. Në fillim, ne u mblodhëm bashkë pasi e ndjenim të nevojshme për ta bërë këtë gjë. Edhe çështjet mbi të cilat përqendroheshim ishin, në njëfarë mënyre... aksione

të vogla, jo në shkallë të gjerë, pasi udhëhiqeshim nga ajo çka dinim. Nuk është se erdhi dikush dhe na tha që do të na jepnin para po t'i bënim këto gjëra. Prandaj thashë që kjo ndodhi më '93 dhe '94, sepse atëherë e kishim krijuar një ide mbi projektet dhe financimin [e tyre], por, në fillimet e hershme, "Refleksione" ishte për bashkimin për të bërë diçka. Gjithësesi, vendosëm mbi programin pasi ishim të detyruara t'i paraqisnim Ministrisë jo vetëm vullnetin për të krijuar një organizatë [por edhe funksionin që do të kishte kjo organizatë]. Vendosëm mbi disa pika, si p.sh., arsyeja pse e themeluum shoqatën, etj.

V.S.: Në njëfarë kuptimi ne po identifikonim nevojat, po kjo është diçka për të cilën mund të flasim me orë të tëra. Prandaj, Valentina, na thuaj se çfarë të shqetëson.

V.B.: Cilat ishin nevojat më urgjente për shoqatën dhe për Shqipërinë në atë kohë?

D.F.: Me këtë do të thuash nevojat më urgjente të shoqatës si e tillë apo nevojat më urgjente sa i përket të drejtave të grave?

V.B.: Të drejtave të grave, dhe mënyrën se si kjo reflektohej në punën e shoqatës.

V.S.: Kjo është e vetëkuptueshme duke qenë se ne zhvilluam pikërisht atë që mendonim se nevojitej. Kështu, e filluam me informacionin: me informimin e grave mbi të drejtat e tyre. Filluam edhe me dhunën, që i dha një tjetër dimension

[punës]. Të drejtat e tyre [grave] lidheshin me të drejtat ligjore, dhe kjo ishte disi strategjike por e bazuar në nevojat e asaj kohe.

D.F.: Shoqata “Refleksione” ishte një ndër grupimet e para por kishte edhe grupime të tjera: ishte Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare, që në thelb u krijua nga një grup i përbërë nga gra udhëheqëse që kishin qenë aktive në Bashkimin e Grave të Shqipërisë (BGSh) gjatë komunizmit; pak më vonë u krijua Shoqata e Grave Artiste Shqiptare “Linda”; pastaj Shoqata “Bashkimi i Grave me Aftësi të Kufizuara të Shqipërisë”; më pas u krijua edhe Shoqata e Grave ish të Përndjekura Politike – pra, midis viteve 1991 dhe ’95, u krijuan një sërë organizatash, 12 në total më duket. Në këtë rrjet [organizatash] ishin 12 grupime pasi përfaqësoheshin edhe Seksioni i Gruas i Partisë Demokratike, Seksioni i Gruas i Partisë Socialiste – nga Merita Ndreka, – kurse partitë e tjera nuk më kujtohen. Pastaj ishte edhe Shoqata Kombëtare e Grave Profesioniste, Afariste e Zejtare të Shqipërisë, që e themeloi Flutura Laknori.

Pra, aty nga fundi i vitit 1995 ekzistonin një sërë grupimesh, rreth 12 të tilla, ose 10 nëse lëmë mënjanë seksionet e partive politike, grupime që mbulonin një gamë të gjerë çështjesh që lidheshin me të drejtat e grave, dhe të gjitha çështjet që u shtruan [nga këto grupime] ishin të rëndësishme. Problemet e grave me aftësi të kufizuara ishin të rëndësishme. Gratë sipërmarrëse filluan të organizoheshin, gratë artiste filluan të organizoheshin. Pastaj ishin edhe gratë ish të përndjekura, që kishin të tjera të drejta dhe të tjera probleme. Kjo për të thënë se “Refleksione” nuk mbulonte gjithçka dhe se kishte edhe lojtarë të tjerë në fushë. Për shembull, Shoqata “Në Dobi të Gruas

Si fillohet një kalendar...

Shqiptare” bëri një punë humanitare të madhe. Ajo gjeti disa donatorë nga Zvicra dhe filloi të shpërndante ushqime për të varfërit, gjë që “Refleksione” nuk e bënte, duke qenë se ishte më tepër një grupim lobimi (*advocacy*). “Refleksione” i krijoi të gjitha këto shërbime por si nisma që u zhvilluan në mënyrë të pavarur: “Refleksione” mbeti një grupim lobimi (*advocacy*).

Unë kam qenë koordinatorja e parë e Qendrës së Gruas, e cila u krijua më 1994 duke hyrë në funksionim në muajin gusht të po atij viti. Qendra u mbështet nga Fondacioni Soros, me një financim prej \$14,000. Përpara saj nuk kishte ekzistuar një qendër e gruas dhe brenda vitit ne kishim një buxhet prej \$100,000, jo vetëm nga Sorosi po edhe nga donatorë të tjerë. Në atë periudhë, nuk kishim mbështetje financiare nga qeveria por bashkëpunim me të nëpërmjet Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, e cila e ka ndryshuar emrin disa herë. Gjithësesi, në atë ministri ka ekzistuar gjithmonë një drejtori që merrej me çështjet gjinore, ndërsa tani ka mbetur vetëm një drejtor. Organizatat e grave në Shqipëri kanë bashkëpunuar përherë me këtë drejtori. Në atë periudhë nuk kishim financim nga qeveria dhe as nuk jam e sigurt nëse morëm ndonjëherë financim nga qeveria.

Para viteve 1990 nuk dija asgjë për të drejtat e grave, prandaj them që kam lindur feministe. Nuk i kisha lexuar ndonjëherë tekstet feministe. Mund edhe t’i kem lexuar – për të drejtat civile i dija disa gjëra...

V.S.: 8 marsi lidhet me Clara Zetkin-in.

D.F.: Po, por nuk dija shumë mbi lëvizjen feministe.

Kisha dijani mbi gjendjen e vështirë të emancipimit të gruas duke qenë se kishte qenë një temë kryesore edhe në projektet komuniste, sepse atëherë na flisnin për emancipimin dhe edukimin e grave. Në fakt, mamaja ime ka qenë kryetarja e njësisë së Bashkimit të Grave të Shqipërisë që mbulonte zonën e “Bllokut”, dhe nëpërmjet saj u ekspozova për herë të parë ndaj dhunës kundër grave. Më kujtohet që ishte një profesor, mësues anglishteje, dhe se gruaja e tij erdhi te mamaja pasi ai e dhunonte. E kishte djegur me cigare në qafë të shoqen; mamaja e futi brenda dhe pastaj vajti të fliste me familjen e tij. Gjithësesi, nuk kisha dëgjuar për Gloria Steinam-in apo për valën e feminizmit, por kishte diskutime mbi emancipimin e gruas pasi ishte pjesë e ideologjisë. Kjo është ajo çka do të thoja. Përvojën tonë e krahasoj me atë të organizatave të grave në ish-Jugosllavi, duke qenë se në ish-Jugosllavi nuk kishte patur ndërprerje të zhvillimit në raport me botën. Puna e tyre informohej shumë nga tekstet feministe, çka nuk ndodhi me ne në fillim: thjesht mendnim se duhej bërë diçka.

V.S.: Unë kisha kontakte që më përpara me disa organizata në Itali, të kujtohet?

V.M.: Në rastin tim, edhe unë mora pjesë në udhëtimin studimor në Shtetet e Bashkuara, por kisha kontakte me shoqatën italiane sepse gruaja e ambasadorit italian ishte juriste. Ajo po shoqëronte bashkëshortin por vetë nuk kishte angazhime atje. Nuk më kujtohet mirë se si u takuam. Ajo kishte kontaktuar Shoqatën e Grave Juriste, që në atë kohë ishte krijuar tashmë, dhe së bashku mboldhëm një grup juristesh [shqiptare] dhe udhëtuam

drejt Italisë, ku u lidhëm me juriste italiane që ishin të përfshira në lëvizjen feministe. Siç e përmendi Delina, në atë periudhë Shqipëria po përgatiste legjislacionin e brendshëm por i duhej që të aderonte edhe në konventat ndërkombëtare pasi më përpara, gjatë periudhës komuniste, nuk kishte qenë e nevojshme të bënim një gjë të tillë. Konventa e parë ishte Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe e dyta ishte Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje. Ishte pikërisht koha në të cilën politika kishte nevojë për lëvizjen feministe. Po flasim për vitet 1992-1993.

V.B.: Kur erdhi në shtëpinë time, ajo [Vjollca] pa të gjithë dokumentacionin e “LindArt”-it sepse duhej të kishim informacionin e plotë, sistemoi gjithçka dhe tha që artistët nuk dinë të merren me dokumente! Pastaj kuptoi që mungonte një dokument.

V.M.: Në Ministrinë e Kulturës unë isha personi që i lexonte ligjet dhe që shikonte gjithçka të zezë mbi të bardhë. Kurse artistët thoshin: “Edhe ti me ligjet e tua!”

V.B.: Elenit nuk i kujtoheshin dhe aq mirë gjërat, kështu që përmes dokumenteve zbuluam që ato u takuan më 1993, pra këto dokumente na ndihmojnë të kuptojmë. Por jam shumë e interesuar edhe për përkthimet. A organizuat protesta për 8 marsin me “Refleksionet”?

V.S.: Siç tha Delina, Qendra e Gruas u kthye në një pikë reference, edhe në ato raste që një ide e caktuar e kishte zanafillën

në një tjetër organizatë. Më pas u krijua një këshill i hapur ku gjithëkush mund të sillte idetë e veta, sepse e kuptonim që nuk mund të bënim gjë vetëm. Një shoqatë (e vetme) nuk mund të mbledhte një grup të madh.

D.F.: Protesta e parë ishte mbi çështjet e mjedisit, më duket. Ajo që dolëm në fotografi para Bashkisë, të kujtohet? Me gjasë në vitin 1993-1994. Dale, jo më 1994 – ishte më 1995.

V.S.: 8 marsi ka qenë një ditë feste përgjatë periudhës komuniste, kështu që në kulturën tonë nuk ishte një ditë proteste. Pra, nuk kishte ndonjë arsyetim: njerëzit e festonin sepse ashtu kishte ndodhur edhe më përpara. Për të qenë e sinqertë, nuk e kishim në rendin e ditës.

V.B.: Ku ndodhej Qendra e Gruas?

D.F.: Në Tiranë, afër Rrugës “Myslym Shyri”. Tani Qendra e Gruas quhet Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim, afër ish-Bllokut. Është një ndër grupet kryesore të grave në Shqipëri.

V.B.: Jam kureshtarë të di mbi literaturën që merrnit si referencë.

D.F.: Do të thoja se, fillimisht, kanë qenë konventat ndërkombëtare. Gjëja e parë që bëmë ishte se përkthyem në shqip Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (e cila u përmend më sipër), dhe madje organizuam edhe një event për të promovuar konventën brenda Piramidës, te

Qendra Amerikane e Kulturës – shfrytëzuan hapësirën e tyre. Nuk i referoheshim ndonjë teksti feminist, dhe ndonëse pozicionet tona ishin që të gjitha pozicione feministe, në fillim nuk kishim një vetëdije feministe të fortë. Kjo vlen jo vetëm për gratë e “Refleksione” por për të gjitha grupimet e grave në Shqipëri. Kishte edhe disa gra, jo në rradhët e “Refleksione” por brenda grupimeve të tjera, që nuk donin të etiketoheshin si “feministe”, pasi ekzistonte një perceptim që feministet i urrenin burrat dhe se ishin radikale. Por kishte gra që ishin feministe për nga mënyra se si silleshin dhe si jetonin, jo vetëm në “Refleksione” por edhe në grupimet e tjera, veçse mungonin deklaratat e qarta në lidhje me të paturit e një vetëdijeje feministe dhe përkatësie feministe. Narrativa sillej rreth të drejtave të grave. Nëse shikon literaturën, tekstet, afishet, nuk ke për të gjetur fjalën “feminizëm” – ajo erdhi më vonë.

Nuk më kujtohet viti por Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare dhe Diana Çuli – ajo është një shkrimtare e njohur – filluan, në një moment të caktuar, një program për përkthimin e letërsisë dhe të teksteve të autoreve femra mbi feminizmin. Kjo ndodhi në vitet 1990, me gjasë në vitin 1996 ose 1997. Ato përkthyen disa tituj të mirë, si dhe letërsi të mirë, por kjo ndodhi më vonë. Në fundvitet '90 do të thoja, por nuk jam e sigurt. Ajo [Diana Çuli] i di datat, por me gjasë kjo ishte një nismë e Forumit të Pavarur të Gruas Shqiptare dhe e Diana Çulit.

V.M.: Dua të përmend këtu një botim që ishte i rëndësishëm në pikëpamjen juridike. Qendra për Edukimin e Grave botonte një periodik sepse një profesor nga universiteti ua kishte rekomenduar studentëve të tij pasi ky periodik i trajtonte

të drejtat e grave në kuptimin ligjor: nga pikëpamja e dhunës kundër grave dhe të zbatimit të konventave [ndërkombëtare]. Nuk më kujtohet titulli por do ta sjell herën tjetër.

V.B.: Më duhet të përfundoj artikullin por kërkimet do vazhdojnë dhe shpresoj të takohemi sërish. Ndoshta për 8 marsin ose me rastin e ekspozitave që do të hapen në qershor.¹⁰

¹⁰ Ekspozita dhe simpoziumi i *Diaries: The Archive as Encounter (Ditarët: Arkivi si Takim)* u hap më 27 qershor 2023. Simpoziumi u zhvillua gjatë datave 27, 28 dhe 29 qershor. Për të mësuar më tepër, ndiqni *link-un* vijues: <https://bulevard.al/sq/whats-on/>.

Si fillohet një kalendar...




Fig. 1. Pjesë nga puna arkivore mbi arkivin e “LindArt” në Academy of Others, 2022. Fotografia është realizuar nga Valentina Bonizzi. Riprodhuar me lejen e autores.



Fig. 2. Kuadër i shkëputur nga video-dokumentimi i takimit të parë të artisteve të “LindArt” më 17 maj 2022. Artistet janë duke parë dokumentarin e vitit 1994 të RTSh-së mbi veprimtarinë e Shoqatës “Linda”. Riprodhuar me lejen e Bulevard Art and Media Institute dhe Academy of Others.



Fig. 3. Fotoalbumi, *Diaries: Lindart & the Albanian Women Artists Association (Ditarët: LindArt & Shoqata e Grave Artiste Shqiptare)*, 2022. Fotografia është realizuar nga Indrit Skëndaj. Riprodhuar me lejen e Bulevard Art & Media Institute.

Si fillohet një kalendar...



Fig. 4. Afishe e ekspozitës *Dare to Be Different (Guxo të jesh ndryshe)* në Bibliotekën dhe Laboratorin e Bulevard Art and Media Institute, si pjesë e ekspozitës *Diaries: Lindart & the Albanian Women Artists Association*, 2022. Fotografi e realizuar nga Indrit Skëndaj. Riprodhuar me lejen e Bulevard Art & Media Institute.



Fig. 5. Dokumentim i instalimit të *Diaries: Lindart & the Albanian Women Artists Association*, 2022. Në fotografi: Kalendarët. Fotografi e realizuar nga Indrit Skëndaj. Riprodhuar me lejen e Bulevard Art and Media Institute.